



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

---

Numri i lëndës: 2020:188472

Datë: 05.04.2024

Numri i dokumentit: 05551916

C.nr. 453/2021

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË- Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtaren Ujëvesë Hysenaj, duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditësit G. I., nga P., Rruga “E. Ç.”, numër .., kundër të paditurit Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, me seli në Prishtinë, Rruga “Xh. B.”, 10 000, me objekt kontesti anulimin e vendimit, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor dhe publik, në praninë e palës paditëse dhe në mungesën e palës së paditur, më datë mori 18.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit G. I. nga P., me të cilën ka kërkuar tw konstatohet dhe të ANULOHET si i kundërligjshëm Vendimi me numër të protokollit 2/41, i datës 02.10.2020 lëshuar nga i padituri Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, dhe të themelohet marrëdhënia e punës në mes të paditurës dhe paditësit, në pozitën “Profesor Asistent për pozitën numër 9 për lëndët: Filozofia dhe Etika në Sport (0), Çështjet ligjore në edukimin fizik dhe sport (Z), Lidershipi dhe Menaxhmenti në edukimin fizik dhe sport (0), Menaxhimi i Objekteve Sportive (Z), në tërësi si E PA BAZUAR.

II. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi si me padi, në seancën e shqyrtimit kryesor ashtu edhe në fjalën përfundimtare, ka theksuar se ka qenë kandidat i vetëm që ka konkurruar në konkursin e shpallur nga i padituri me datë 22.10.2019, përkatësisht në Fakultetin e Edukimit Fizik dhe Sportit, për pozitën në numrin 9, gjegjësisht në lëndët: Filozofia dhe Etika në Sport (0), Çështjet ligjore në edukimin fizik dhe sport (Z), Lidershipi dhe Menaxhmenti në edukimin fizik dhe sport (0), Menaxhimi i Objekteve Sportive (Z). Me tutje ka shtuar se i njëjti është refuzuar që të zgjidhet si kandidat i suksesshëm në kuptim të nenit 177 par.1 pika 1.6 të Statutit të UP-së, më anë të Vendimit me numër 2/41 të datës 02.10.2020. Me tutje ka theksuar se ky vendim është diskriminues dhe në kundërshtim me Kushtetutën dhe aktet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, ngase kriteri i moshës sipas paditësit ka qenë diskriminues. Paditësi ka shtuar se i plotëson të gjitha kriteret e përzgjedhjes sipas Procedurave të Rregullores për Zgjedhje, Emërimet dhe Avancime të stafit akademik tek e paditura.

Paditësi ka theksuar se padia e ti ka mbështetje në Kushtetutën Kosovës, nenin 49, 54, dhe 113, në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Ligjin e Punës, nenin 5 paragrafin 1, dhe nenin 7, si dhe Ligjin për Mbrojtje nga Diskutomini përkatësisht nenin 1 paragrafi 1, i po këtij ligji.

Mbi bazën e të lartëcekurave i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadia e paditësit te aprovohet në tërësi si e bazuar.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

E paditura, në seancën e datës 12.02.2024, nëpërmjet të autorizuarit të saj, ka kërkuar shtyrjen e seancës për shkak të mungesës së informacioneve në lidhje me rrjedhën e çështjes lëndore kontestimore, ku gjykata në seancën e lartpërmendur ka obliguar të paditurën që brenda afatit ligjor të paraqes përgjigje në padi dhe ka shtyrë seancën gjyqësore, mirëpo e paditura nuk ka paraqitur përgjigje në padi, si dhe ka munguar pa arsye në seancën gjyqësore të caktuar me datë 18.03.2024, andaj gjykata nuk ka mundur të konstatojë asnjë pretendim nga ana e të paditurës.

Gjykata me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike sipas propozimit të palëve ka zhvilluar procedurën dhe ka administruar këto prova: raporti i komisionit vlerësues për zgjedhjen e personelit akademik nr.557 i datës 19.11.2019, ekstrakti nga procesverbali i mbledhjes të Këshillit të Fakultetit i datës 13.12.2019, referenca e paditësit, vërtetimi nr.498 i datës 05.11.2019, letër rekomandimi i lëshuar nga Programi i Trajnimit të Trajnerëve në Nivelin Post Diplomik në edukimin fizik dhe sport projekt i financuar nga BE, vendimi nr.ref.6-2585 date 03.09.2019, vërtetimi i përvojës së punës i datës 11.06.2015, akt emërimi i datës 01.06.2012, vendimi nr.ref.6-2588 date 28.06.2019, vendimi i datës 03.07.2019, CV-ja e paditësit, buletini i referateve të kandidatëve të paraqitur për zgjedhjen e personelit akademik i datës 25.11.2019, njoftimi i datës 10.06.2020, vendimi për miratimin e komisionit për ankesa dhe parashtrësia për refuzimin e ankesës së paditësit, vendimi i të paditurës me nr.2/41 date 02.10.2020, ankesa e datës 24.06.2020 ,ankesa e dorëzuar në IP e Kosovës ankesa e datës 24.07.2020, shpallja e konkursit e datës 22.10.2019, ankesa e datës 23.10.2020, certifikata e lindjes për paditësin e lëshuar me date 24.10.2019, pasqyra lidhur me zgjedhjen e stafit akademik, dhe konkursi i datës 22.10.2019 nr.2/872.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të nxjerra në kuptim të nenit 8 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar.

Gjykata konstaton se paditësi konform dispozitave ligjore nga nenet 78 dhe 79 të Ligjit të Punës, i ka plotësuar kushtet ligjore për të iniciuar kontest pune në gjykatë. Padia është brenda afatit ligjor të përcaktuar.

Mes palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese se e paditura kishte hapur konkurs për pranimin e personelit akademik me datë 22.10.2019 dhe se paditësi kishte qenë pjesë e këtij konkursi, duke aplikuar në Fakultetin e Edukimit Fizik dhe Sportit, për pozitën në numrin 9, gjegjësisht

në lëndët: Filozofia dhe Etika në Sport (0), Çështjet ligjore në edukimin fizik dhe sport (Z), Lidershipi dhe Menaxhmenti në edukimin fizik dhe sport (0), Menaxhimi i Objekteve Sportive (Z), si dhe i njëjti ka qenë i rekomanduar nga Raporti i Komisionit Vlerësues për Zgjedhjen e Personelit Akademik, edhe atë me anë të raportit të datës 19.11.2019, me numër 557, si dhe në ekstraktin e procesverbalit të Këshillit të Fakultetit të Edukimit, edhe atë të datës 13.12.2019.

Çështje kryesore kontestuese mes palëve ndërgjyqëse mbetet nëse refuzimi i zgjedhjes së paditësit në thirrjen si profesor asistent ka qenë i drejtë dhe në përputhje me dispozitat juridike relevante, çështje për të cilën në thelb palët kishin pikëpamje diametralisht të kundërta.

Nga raporti i komisionit vlerësues për zgjedhjen e personelit akademik nr.557 i datës 19.11.2019, gjykata ka vërtetuar se paditësi nga Komisioni vlerësues paditësi është përzgjedhur për të u emëruar si profesor asistent.

Nga ekstrakti nga procesverbali i mbledhjes të Këshillit të Fakultetit i datës 13.12.2019, gjykata ka vërtetuar faktin se Këshilli i Fakultetit të Edukimit ka miratuar me vota unanime që paditësi të zgjidhet profesor asistent.

Nga vërtetimi nr.498 i datës 05.11.2019, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi është në marrëdhënie të rregullt pune nga data 14.11.2005 tek e paditura, gjegjësisht në pozitën e Sekretarit në Fakultetin e Edukimit Fizik dhe Sportit.

Nga vendimi nr.ref.6-2585 date 03.09.2019, gjykata ka vërtetuar se paditësit i njihet grada “Magjistër i Shkencave Juridike – Drejtimi Jurispodencë (Master)”, e marrë në Universitetin Fon, në Republikën e Maqedonisë.

Nga buletini i referateve të kandidateve të paraqitur për zgjedhjen e personelit akademik të datës 25.11.2019, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi në lidhje me aplikimin e tij si Profesor Asistent për lëndët: Filozofia dhe Etika në Sport (0), Çështjet ligjore në edukimin fizik dhe sport (Z), Lidershipi dhe Menaxhmenti në edukimin fizik dhe sport (0), Menaxhimi i Objekteve Sportive (Z), sipas konkursit të shpallur me datë 22.10.2019, i është refuzuar emërimi për shkak të moshës.

Nga njoftimi i datës 10.06.2020, gjykata ka vërtetuar se mos-përzgjedhja e paditësit ka ardhur si rezultat i mos plotësimit të kushtit nga neni 177, pika 1.6 e Statutit të paditurës.

Nga vendimi për miratimin e komisionit për ankesa dhe parashtresa për refuzimin e ankesës së paditësit, vendimi i të paditurës me nr.2/41 date 02.10.2020, gjykata ka vërtetuar se Senati i të paditurës, ka miratuar propozimin e Komisionit për Ankesa dhe Parashtresa në kuadër të të paditurës, me propozimin që ankesa e paditësit e dorëzuar me datë 24.06.2020 të refuzohet si e pabazuar, si dhe të mbetet në fuqi Vendimi/Njoftimi me numër 1/339, i datës 10.06.2020, me të cilin është refuzuar propozimi për thirrje akademike të paditësit.

Nga ankesa e dorëzuar në IP e Kosovës ankesa e datës 24.07.2020, gjykata ka vërtetuar se paditësi i është drejtuar Inspektoratit të Punës në lidhje me çështjen lëndore.

Nga shpallja e konkursit e datës 22.10.2019, gjykata ka vërtetuar se e paditura ka hapur konkursin me datën e lartpërmendur, edhe atë përkitazi me Fakultetin e Edukimit, është hapur pozita për Profesor Asistent për lëndët: Filozofia dhe Etika në Sport (0), Çështjet ligjore në edukimin fizik dhe sport (Z), Lidershipi dhe Menaxhmenti në edukimin fizik dhe sport (0), Menaxhimi i Objekteve Sportive (Z).

Nga certifikata e lindjes për paditësin e lëshuar me date 24.10.2019, gjykata ka vërtetuar se paditësi ka lindur me datë 06.09.1960, e që në momentin e aplikimit të paditësit për pozitat e lartcekura sipas konkursit të datës 22.10.2019, vërehet se i njëjti ka pasur 59 vite.

Ligji nr. 04/l-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, në nenin 13 par. 2 nën par. 2.5 parasheh: *“Bartësit e licencuar të arsimit të lartë gëzojnë të drejtat nga dispozitat e këtij ligji për të dhënë tituj profesorëve dhe personelit tjetër, në pajtueshmëri me këtë ligj, me ligjin në fuqi për punësim si dhe skemën e aprovuar nga AKA-ja. Këto kritere përcaktohen në statutin e bartësit”*. Kurse neni 13 par. 2.3 rregullon se bartësit e arsimit të lartë gëzojnë të drejtë të për të: *“zgjedhur mësimdhënësit dhe personelin tjetër, për të përcaktuar kushte lidhur me pranimin e studentëve, metodat e mësimdhënies dhe vlerësimin e studentëve, të miratuara nga AKA-ja”*. Neni 174 i Statutit të UP-së përcakton: *“Kushtet për emërimin dhe avancimin në çfarëdo titulli të personelit akademik janë kualifikimet përkatëse dhe përvojat relevante për vendin e punës”*. Kurse neni 177 par. 1 i numëron kualifikimet të cilat duhet të plotësohen për t’u fituar titulli i profesorit asistent, kështu që: *“Për titullin e profesorit asistent kandidati duhet t’i plotësojë këto kushte: 1.1. Të ketë gradën e doktorit të shkencës; 1.2. Të ketë një numër të zgjedhur të monografive dhe publikimeve të shqyrtuara në revista ndërkombëtare shkencore ose artistike më së paku një punim kryesor të publikuar dhe të shqyrtuar në revista ndërkombëtare, si autor i parë ose korrespondent; 1.4. Të tregojë aftësi për mësimdhënie; 1.5. Të ketë së paku tri vite përvojë pune në procesin mësimor në Arsimin e lartë; 1.6. Kandidati i cili zgjidhet për herë të parë, nuk mund të jetë më i vjetër se 50 vjet”*.

Përmes provave të administruara gjykata gjeti se paditësi ka qenë i angazhuar që nga data 14.11.2005 tek e paditura, dhe përkitazi me lëndët e aplikuara nga paditësi për pozitën e profesor-asistent, të njëjtit i është refuzuar emërimi vetëm sa i përket kriterit të moshës nga pika 1.6 e par.1 të nenit 177 të Statutit. Çështja kryesore të cilën paditësi e ka ngritur në padi dhe gjatë seancave gjyqësore përmes të autorizuarës së tij ka qenë diskriminimi në punësim, që siç ka pretenduar shkaktohet nga përmbajtja e nenit 177 i Statutit të UP-së, konkretisht par.1, pika 1.6 e të njëjtit nen, e cila përcakton se: *“Kandidati i cili zgjidhet për herë të parë[në titullin profesor asistent], nuk mund të jetë më i vjetër se 50 vjet”*.

Lidhur me fuqinë e statutit të të paditurës, gjykata vlerëson të theksoj se ai është i miratuar nga Kuvendi i Kosovës, si akt i përgjithshëm që rregullon organizimin e universitetit, në këtë mënyrë normat e tij kanë fuqi detyruese në aplikim, të kateterit ligjor. Për sa i përket kompetencave që i janë dhënë të paditurës, me Ligjin për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, gjegjësisht neni 13 par. 2, e njëjta si bartëse e arsimit të lartë ka të drejtë të rekrutoj pozita për mësimdhënës bazuar planet e tyre të brendshme, duke aplikuar statutin e miratuar nga Kuvendi. Në këtë mënyrë e paditura ka autonomi në vendimmarrje, mes tjerash për sa i përket zgjedhjes së stafit akademik. Rrjedhimisht e paditura ka bërë aplikim të normës statutores, të cilën nuk e kishte nxjerrë, por që ishte miratuar nga organi ligjvënës.

Përgjatë procedurës është paraqitur pretendim se norma statutores, që moshën si kitet për t’u punësuar si profesor për herë të parë, ka karakter diskriminues. Lidhur me këtë fakt theksohet

neni 3 par. 2 i Ligjit nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i cili përcakton kuptimin e diskriminimit, sipas të cilit: *“Diskriminim është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë në çfarëdo baze të përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji, që ka për qëllim apo efekt të zhvleftësor ose cenor njohjen, gëzimin ose ushtrimin, në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave dhe lirive themelore të njohura nga Kushtetuta dhe ligjet tjera të aplikueshme në Republikën e Kosovës”*. Diskriminim bazuar në moshën si kriter, do të konsiderohej, nëse punëdhënësi personat pretendent për një pozitë të caktuar, që posedojnë kualifikim të njëjtë dhe moshë të njëjte, nga punëdhënësi trajtohen në mënyrë të ndryshme, në këtë mënyrë një person pranon kushte më të favorshme krahasuar me të tjerët. Përderisa norma statutore është nxjerrë me qëllim të aplikimit gjeneral, për të gjithë personat që aplikojnë sipas konkurseve që shpall e paditura.

Duhet të behet ndarje për sa i përket pretendimit për karakterin diskriminues të nenit të statutit të të paditurës, si dhe diskriminimit në aplikim të nenit statutor. Për sa i përket pretendimit se neni i statutit si i tillë është diskriminues, gjykata vlerëson se i njëjti është i miratuar nga Kuvendi i Kosovës, i ngritur në nivel të normës ligjore, që zbatimi i tij do të rregullonte premisat e përzgjedhjes së stafit akademik. Kurse aplikimi diskriminues i normës statutore nga e paditura, do të nënkuptonte se ajo të njëjtën normë do ta aplikonte në mënyrë të ndryshme tek disa aplikues. Në vijimësi të këtij interpretimi, në qoftë se përgjatë procedurës do të rezultonte se e paditura, të njëjtën normë statutore do ta aplikonte në mënyrë jo uniforme kundrejt disa aplikuesve, atëherë do të gjenin vend dispozitat ligjore që ndalojnë diskriminim, kurse veprimet e të paditurës do të cilësoheshin si diskriminuese.

Gjykata e rregullt, çështjet që shtrohen para saj i gjykon mbi bazën e ligjeve që janë të aplikueshme në kohën e krijimit të raportit, duke zbatuar secilën normë në mënyrë sistematike, varësisht nga hierarkia. Në rastin kontestues pas vlerësimit të provave, është gjetur se e paditura ka zbatuar një normë ligjore që ndalon zgjedhjen për herë të parë të një aplikuesi për profesor. Vihet në dukje se kontrollin abstrakt të normës ligjore, më tej, dhënia e cilësisë se ka karakter diskriminues, gjykata e rregullt është e kufizuar në këtë pikë. Porse kjo gjykatë mund të jep cilësi të vendimeve të të paditurës të nxjerra në aplikim të normës së caktuar ligjore. Neni 4 i Ligjit nr. 06/L- 054 për Gjykatat rregullon: *“Gjykatat e themeluara me këtë ligj gjykojnë në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe ligjet në fuqi në Republikën e Kosovës”*. Duke interpretuar në mënyrë sistematike, sipas normave juridike relevante, gjykata veçon nenin 24 par. 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, i cili parasheh se: *“Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare e shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal”*. Në aplikim të normës ligjore, është detyrë e gjykatës të aplikoj një normë kushtetuese, që rregullon një raport të caktuar. Epërsia e saj në raport me aktet tjera juridike është evidente, kurse gjykata mundet të aplikoj të njëjtën, në qofte se rregullon një raport të caktuar. Ndonëse kjo normë kushtetuese nga neni 24 ndalon diskriminimin në disa forma të tij, nuk mund të arrihet në përfundim, se vendimet e të paditurës janë marrë në kundërshtim të këtij neni.

Gjatë seancës së shqyrtimit kryesor gjykata ka administruar edhe prova tjera si: raporte dhe dokumente, mirëpo të njëjtat nuk u arsyetuan posaçërisht, ngase nuk kishin rëndësi vendimtare që do të shpënin në vendosjen ndryshe si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi për shpenzimet e procedurës është marrë në bazë të nenit 463 par. 1 dhe 2 sipas të cilit *“Për pagimin e shpenzimeve procedurale gjykata vendosë vetëm me kërkesën specifikuar*

të palës, pa bërë asnjë shqyrtim verbalisht lidhur me kërkesën” dhe “*Pala ka për detyrë që në kërkesën e saj në mënyrë të specifikuar t’i tregoj shpenzimet për të cilat kërkon shpërblim, duke parashtruar prova për shpenzimet e bëra, po që se nuk ekzistojnë provat e tilla në dosjen e lëndës.*” Meqenëse përfaqësuesi i palës së paditur nuk i ka specifikuar shpenzimet e saja detyrë e cila rëndon sipas neneve të sipërcituara, u vendos si në dispozitivin e II (dytë) të këtij aktgjykimi. Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm  
C.nr.453/21 datë 18.03.2024

Gjyqtarja  
Ujëvesë Hysenaj

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.

Numri i lëndës: 2020:188472  
Datë: 05.04.2024  
Numri i dokumentit: 05551916